

Përshëndetje,

E nderuara znj. Avakyan dhe z. Penner - përfaqësues të Organizatës
Financat Ndërkombëtare për Fëmijë dhe të Rinj

E nderuara znj. Prela, Përfaqësuese e Bankës së Shqipërisë

I nderuar Z. Balija – Kryetar i Shoqatës së Bankave, dhe

Përfaqësues të të gjitha institucioneve të Kosovës

Jam i nderuar që jam në mesin tuaj sot, dhe ju përgëzoj për idenë e mbajtjes
së këtij trajnimi, gjithashtu për bashkimin e të gjitha institucioneve
kosovare që mund të kontribuojnë në ngritje të edukimit financiar.

Një ndër qëllimet strategjike të BQK-së, është nxitja e zhvillimit të
shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi i
mëtitjeshëm i funksionit të edukimit financiar, me qëllim të krijimit të
kulturës së mirëfilltë financiare, që u ndihmon të gjitha palëve të interesit
për të marrë vendime të duhura.

Në mjedisin e sotëm, kur sistemi financiar është duke evoluar në zgjerimin
e produkteve dhe shërbimeve financiare më komplekse, çështja e edukimit
financiar gjithnjë e më shumë zë një rol të veçantë në agjendën e
rregullatorëve por edhe institucioneve financiare. Aq më tepër kur sektori i
shërbimeve financiare ka një peshë të fuqishme në rritjen ekonomike,
krijimin e vendeve të punës, ndërtimin e infrastrukturës vitale dhe zhvillim
të qëndrueshëm për Kosovën.

Zhvillimi i një mjedisi të sigurt dhe të drejtë për ofrimin e shërbimeve
financiare është një nga qëllimet kryesore strategjike të Bankës Qendrore të
Kosovës. Banka Qendrore e ka zhvilluar tashmë strategjinë e vet për
mbrojtjen e konsumatorit, strategji e cila fokusohet në ofrimin e ndihmës
ndaj përdoruesve të shërbimeve financiare për të marrë vendime duke
qenë të informuar drejt dhe me kohë për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Paralelisht, përpjekjet tona për mbrojtjen e konsumatorëve orientojnë dizajnimin e programit adekuat për edukimin financiar.

Shërbimet dhe produktet e sektorit financiar prekin jetën e secilit qytetar të Kosovës. Prandaj, BQK-ja inkurajon të gjitha institucionet financiare në ndërtimin e një tregu financiar që trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë, inkurajon përfshirjen financiare dhe ndihmon qytetarët në përdorimin efektiv të shërbimeve financiare. Njëkohësisht, është po aq e rëndësishme që qytetarët vazhdimisht të kërkojnë informata për të krahasuar kushtet dhe afatet e produkteve financiare - dhe më e rëndësishme është që ata të ngrejë zërin e tyre në qoftë se ndeshën me probleme. Gabimet ndodhin, andaj institucionet financiare duhet të jenë të vetëdijshme për gabimet dhe t'u jepet një shans për t'i korrigjuar ato - por nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë, BQK-ja në bashkëpunim me institucionet relevante për mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve do të reagojë me kohë në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi.

Vendimet e konsumatorëve për shfrytëzim të produkteve dhe shërbimeve merren mbi bazën e informacionit të plotë dhe të drejtë, si dhe njohurive që kanë për të kuptuar këto informacione, prandaj edhe shpalosja e tyre nga institucionet financiare është shumë kritike. Për më tepër qasja e tillë shpie drejt një konkurrence të drejtë të të gjithë akterëve të sektorit financiar.

Edukimi financiar është proces aktiv, në të cilin komunikimi i informatave është vetëm fillimi. Fuqizimi i konsumatorëve për të marrë veprime për përmirësimin e mirëqenies së tyre është qëllimi final. Ndër efektet pozitive të edukimit financiar janë sjelljet financiare të qytetarëve, menaxhim më të mirë të buxhetit personal, menaxhimi i kursimeve, menaxhimi i kredive, sjellja pozitive financiare afatgjate.

Menaxhimi i mirë i financave nuk është e mirë vetëm për qytetarët po në fakt ka efekt pozitiv edhe në interesa afatgjate të shtetit dhe rrjedhimisht ndikim në rritje ekonomike.

BQK-ja është e përkushtuar të kontribuojë në rritjen ekonomike në vend dhe e përkushtuar të punojë drejt ngritjes së cilësisë në të gjithë sektorin financiar e mbi të gjitha të kontribuojë në mbrojtjen e konsumatorit.

Gjithashtu duhet të përmendim, që anëtarësimi në Organizatën Financat Ndërkombëtare për Fëmijë dhe të Rinj, ka ndikuar në nxitjen dhe inspirimin e zhvillimit të shumë aktiviteteve në kuadër të edukimit financiar në BQK.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të jetë e përkushtuar që në bashkëpunim me institucionet relevante të vazhdojë me implementimin e programit afatgjatë të edukimit financiar. Edukimi financiar do të mundësojë që të avancojë kulturën mbi konceptet themelore financiare për të drejtat e konsumatorëve por edhe obligimeve të tyre siç janë rregullat për huamarrje të përgjegjshme.

Gjithashtu, vlerësoj që kjo punëtori do të ofrojë një rrugë për të forcuar dhe ngritur këtë bashkëpunim. Prandaj krijimi i ndonjë grupi punues që të sigurohet qasje e koordinuar rreth edukimit financiar të publikut do të ishte ide e mirë.

Ju dëshiroj punë të mbarë dhe sukses në këtë trajnim.